LIGJ
Nr. 97/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 25/2022, "PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-eve", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Titulli i ligjit ndryshon si më poshtë:
"Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve dhe inovacionit".
2. Kudo në tekst togfjalëshi "nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve" zëvendësohet me togfjalëshin "nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit".
3. Kudo në tekst togfjalëshi "ministri përgjegjës për sipërmarrjen" zëvendësohet me togfjalëshin "ministri përgjegjës për inovacionin".

Neni 2

Në nenin 1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Mbështetjen e ekosistemit vendas të *startup*-eve dhe të inovacionit nëpërmjet bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve të tij dhe integrimit me ekosistemin ndërkombëtar për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve e proceseve të reja në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.".

Neni 3

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat dhe organet shtetërore, që rregullojnë, mbështesin, zhvillojnë dhe integrojnë ekosistemin e *startup*-eve dhe inovacionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe format e mbështetjes së punonjësve lëvizës digjitalë.".

Neni 4

1. Në nenin 3, shkronja "d" ndryshohet si më poshtë:
"d) "*Startup*" janë individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët referuar objektit të aktivitetit të tyre janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese. Për

efekt të këtij ligji, termi "*startup*" përfshin edhe "*scale-up*" që janë *startup*-e që ndodhen në fazën e zgjerimit të shpejtë dhe të rritjes së ndjeshme të veprimtarisë së tyre;".

2. Pas shkronjës "d" shtohen shkronja "dh", "e", "ë' dhe "f" me këtë përmbajtje:

"dh) "Instrumentet financiare" janë masat e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit ose burime të tjera të ligjshme, që nuk janë investime publike, me qëllim arritjen e objektivave të politikave shtetërore, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në grante, financime nëpërmjet kapitalit, mbulimin e kostove të pranueshme të përcaktuara për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, si dhe mekanizmat e lehtësimit të rrezikut;

e) "Masa mbështetëse" janë instrumentet teknike, që lehtësojnë proceset e inovacionit dhe synojnë të forcojnë kapacitetet dhe njohuritë përkatëse të *startup*-eve, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në ofrimin e aksesit në infrastrukturat e kërkimit dhe testimit, shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare apo të biznesit, transferimit të teknologjisë dhe vënies në dispozicion të infrastrukturës teknologjike;

ë) "Inovacion" është çdo produkt, shërbim ose proces i ri ose kombinim i tyre, që ndryshon ndjeshëm nga trajta e produktit, shërbimit ose procesit të mëparshëm, duke përfshirë njësitë e administratës publike, dhe që është i disponueshëm për përdorues të mundshëm të produktit ose që vihet në përdorim nga vetë njësitë;

f) "Aktivitete inovacioni" janë të gjitha veprimtaritë me karakter zhvillimor, financiar dhe tregtar, që ndërmerren nga një subjekt i të drejtës private ose publike, që kanë për synim të realizojnë inovacion për atë subjekt.".

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4
Objektivat e mbështetjes së *startup*-eve dhe inovacionit

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve dhe inovacionit ka për synim:

a) lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së *startup*-eve;

b) krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit, dhe burimeve njerëzore;

c) lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse;

ç) përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike;

d) nxitjen e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve të ekosistemit për zhvillimin e aktiviteteve të inovacionit dhe përdorimin e teknologjisë.".

Neni 6

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Format e mbështetjes së *startup*-eve dhe inovacionit

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve dhe inovacionit kryhet nëpërmjet:

a) shërbimit "*startup one-stop-shop*" për mbështetjen e *startup*-eve;

b) zhvillimit të ekosistemit mbështetës për *startup*-et dhe inovacionin;

c) dhënies së instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse për zhvillimin e *startup*-eve;

ç) formave të tjera mbështetëse e lehtësuese të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 7

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Organet përgjegjëse

Organet përgjegjëse në fushën e nxitjes, ndihmës dhe zhvillimit të *startup*-eve dhe inovacionit sipas këtij ligji janë:

a) ministri përgjegjës për inovacionin;

b) këshilli i *startup*-eve;

c) ministritë ose institucionet e tjera publike;

ç) agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit.".

Neni 8

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7
Detyrat e ministrit përgjegjës për inovacionin

1. Ministri përgjegjës për inovacionin ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e mbështetjes së *startup*-eve dhe inovacionit;

b) koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të *startup*-eve dhe inovacionit, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të sipërmarrjes në vend;

c) koordinon me ministrinë përgjegjëse për financat për planifikimin buxhetor të *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;

ç) i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për instrumentet financiare dhe masat mbështetëse së *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

d) miraton modelet tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që nënshkruhen ndërmjet agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit, lehtësuesve dhe palëve të treta;

dh) miraton dhe publikon thirrjet për instrumentet financiare dhe masat mbështetëse, ku evidentohet forma dhe sasia e financimit ose forma e instrumentit, ose masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;

e) miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të *startup*-eve;

ë) mbikëqyr administrimin e regjistrit të *startup*-eve dhe të lehtësuesve në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

f) administron faqen zyrtare të internetit të institucionit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, si edhe publikon thirrjet për financim dhe masa mbështetëse;

g) asiston zhvillimin e ekosistemit mbështetës për *startup*-et dhe inovacionin;

gj) vepron si organ mbështetës për *startup*-et, lehtësuesit dhe palët e treta, duke bërë të mundur tërheqjen dhe duke mbështetur alokimin e financimit ose të masave mbështetëse të donatorëve të huaj për ekosistemin në Shqipëri;

h) bashkëpunon me institucionet vendase, organizatat ndërkombëtare dhe me organizatat jofitimprurëse vendase e të huaja për rritjen e ndërgjegjësimit publik në fushën dhe veprimtarinë e *startup*-eve dhe inovacionit, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ky ligj;

i) të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.".

Neni 9

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "a" fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"asistojnë procesin e mbështetjes dhe të zhvillimit të *startup*-eve dhe inovacionit në përputhje me parimin pa letër dhe tarifa zero në ofrimin e shërbimeve;".

2. Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) japin mendim të arsyetuar për përputhjen ligjore midis aplikimit të *startup*-it, lehtësuesit ose palëve të treta, kërkues për financim ose masa mbështetëse dhe fushën e tyre të aktivitetit;".

Neni 10

Neni 9/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9/1

Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit

l. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit është njësia menaxhuese dhe monitoruese e realizimit të financimit nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse nëpërmjet fondeve publike ose nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tjerë për nismat në ekosistemin e *startup*-eve dhe inovacionit.

2. Rregullat për funksionimin dhe organizimin e agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve, lehtësuesve dhe inovacionin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 11

Në nenin 11, pika 2, pas togfjalëshit "për kërkuesit dhe përfituesit" shtohet togfjalëshi "e financimit edhe të masave mbështetëse".

Neni 12

Në nenin 14 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

"Mbështetja e *startup*-eve, lehtësuesve të *startup*-eve dhe inovacionit nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. *Startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve të vetëdeklaruar në regjistër mund të përfitojnë mbështetje me fonde buxhetore nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë, por pa u kufizuar në donacionet e huaja dhe/ose nga investimet e lehtësuesve, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.".

3. Në pikën 3 togfjalëshi "për përfitimin e granteve" zëvendësohet me togfjalëshin "për përfitimin e financimit nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse".

4. Në pikën 6 togfjalëshi "për përfituesit e granteve financiare" zëvendësohet me togfjalëshin "për përfituesit e financimit nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse.".

Neni 13

Në nenin 15, pika l, togfjalëshi “që kanë fituar masë mbështetëse nëpërmjet granteve” zëvendësohet me togfjalëshin “që kanë fituar financim nëpërmjet instrumenteve financiare dhe masave mbështetëse”.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 517, datë 31.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.